

KËRKESË
Nr. 931/7, datë 13.3.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass i Fierit”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaqëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit të publikimit në gazetën “Koha jonë” dhe “Mapo”, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre (lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë etj.) të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit). Publikimi në gazetën “Koha Jonë” dhe “Mapo” do të bëhet nga data 26.2.2013 - 4.3.2013.

Për pasuritë për të cilat nuk ka konfirmim apo nuk disponojnë dokumente hipotekore, për të cilat është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, “Plotësim dokumentacioni”, personat të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre ose të paraqesin dokumentacionin tekniko-ligjor, pasi në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për pasuritë për të cilat në kolonën shënime shkruhet “Rikonfirmim”, sqarojmë se do t’i kërkohet zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier, konfirmimi i gjendjes juridike të tyre. Pasuritë “Shtet” dhe “Të paidentifikuara”, por që rezultojnë me pronar pretendues, personat që pretendojnë pronësinë duhet që menjëherë të fillojnë procedurat për regjistrimin e tyre pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier.

Likuidimi i pasurive, të cilat janë të ngarkuara me barra hipotekore në favor të bankave, do të bëhet pasi pronarët të kenë shlyer detyrimet përkatëse me bankat, si dhe pasi të kenë depozituar dokumentacionin e plotë të pronësisë, të rifreskuar dhe pa barra hipotekore, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar. Pasuritë të cilat janë në proces legalizimi do të likuidohen në bazë të kuadrit ligjor në fuqi.

Pasuritë e kufizuara nga Drejtoria e Tatimeve apo debitor tek ATK-ja, do të likuidohen pasi të kenë hequr çdo ngarkesë të mundshme në dokumentacionin tekniko-ligjor të rifreskuar nga ZVRPP-ja.

Pasuritë e ndara do të rikonfirmohen nga ZVRPP Fier në mënyrë që të merret gjendja e saktë juridike e pasurisë.

Vlera totale e tokës bujqësore, truallit dhe objekteve është 483 121 737 (katërqind e tetëdhjetë e tre milionë e njëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

**ZËVENDESMINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Ernest Noka**